



KOMUNA E GJAKOVËS

publika e Kosovës, Republika Kosovo  
Opština Djakovica, Municipality of Djakovica  
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administratë  
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove

01 Nr./Br. 112102-37072  
Data/Datum 01.10.19

Gjakovë-Djakovica-Gjakova

Kuvendi i Komunës së Gjakovës  
01 Nr. \_\_\_\_\_/2019  
Datë: 27.09.2019

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 5, 6, 8 dhe 14.3 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.09.2019 pas diskutimit lidhur me pikën 6 të rendit të ditës: Shqyrtimi i Propozim Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme Komunale- Tabhanës me numër të parcelës 02288-1 dhe 02288-2 si dhe të objekteve përcjellëse, e miratoi këtë:

**V E N D I M**

Paraparak për  
Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komunale

1. Miratohet vendimi paraparak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale – Tabhanës, në parcelat me numër 02288-1 dhe 02288-2, në pronësi të Komunës së Gjakovës.
2. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale - Tabhanës, me parcelat me numër 02288-1 dhe 02288-2 është afatshkurtër.
3. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër realizohet përmes ankandit publik në harmoni me Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënin në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.
5. Vendimi iu dërgohet:
  - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
  - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
  - Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë
  - Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
  - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
  - Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës  
Anton Shala